



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë

Nr. 826/8 Prot

Tiranë, më 25.09.2023

PROCES-VERBAL ARGUMENTIM KRITERESH

1. Relacion I Grupit të Punës për FIVET -in me e dërguar në MSHMS me Nr. 1001/1 prot, datë 09/09/2022.
2. Relacion I Grupit të Punës për Qendrën e Riprodhimit të Asistuar e dërguar në MSHMS me Nr. 1001/2 prot, datë 12/12/2022.
3. Relacion I Grupit të Punës për Qendrën e Riprodhimit Mjekësor të Asistuar e dërguar në MSHMS me Nr 634 prot, datë 23/06/2023
4. Kërkesë miratim medikamente dhe materjale mjekimi për Qendrën e Riprodhimit Mjekësor të Asistuar e dërguar në MSHMS me nr.prot 634/3 datë 29/06/2023
5. Shkresa me Nr. 2529/1 Prot, date 05.07.2023 te MSHMS, me tonen Nr. 634/4 Prot, date 06.07.2023 me obehjt "Kthim pergjigje per miratim liste per medikamente dhe materjale mjekimi për Qendrën e Riprodhimit Mjekësor të Asistuar.
6. Shkresa me Nr. 826/2 Prot, datë 19.09.2023 me objekt: "Kërkesat për Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni", nga specialisti i fushës.
7. Shkresa me Nr. 826/3 Prot, datë 19.09.2023 me objekt: "Kërkesat për Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni", nga grupi i punës.
8. P.V fondi limit Shkresa me Nr. 826/4 Prot, datë 19.09.2023 me objekt: "P.V fondi limit për Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni", nga grupi i punës.
Mbeshtetur në nenin 52 te Ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin Publik ", VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 neni 52 "Procedurë e hapur", neni 60 për nevojat S.U.O.GJ "Koco Gliozheni", të përdoret Procedurë e Hapur, MK 12 muaj **Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni" për Qendrën e Riprodhimit të Asistuar Mjekësor**" MK me afat 12 Muaj.

Njesia e Prokurimit e ngritur me Urdhërin e Prokurimit Nr. 826/5 Prot, datë 19.09.2023 SUOGJ "Koço Gliozheni" përgatiti kriteret për: Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në

S.U.O.GJ "Koço Gliozheni" për Qëndrën e Riprodhimit të Asistuar Mjeksor" MK me afat 12 Muaj Tiranë.

Prokurimin me objekt: Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni" për Qëndrën e Riprodhimit të Asistuar Mjeksor" MK me afat 12 Muaj ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Specifikimet teknike bazuar në P-V Nr 826/7 Prot, datë 25.09.2023

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Materjale Laboratorike dhe Terrenet e Kultivimit në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni" për Qëndrën e Riprodhimit të Asistuar Mjeksor" MK me afat 12 Muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Produkte mjeksore te konsumueshme.

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,647,771 (shtatembdhjete milion e gjashtëqind e dyzet e shtate mije e shtateqind e shtatedhjete e nje) leke pa tvsh, bazuar ne P-V fondi limit me studim tregu Nr. 826/3 Prot, date 19.09.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Formular oferte sipas shtojces 1
 - b. Lista e çmimeve të artikujve sipas shtojces 2
 - c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
 - d. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 ose/ ekuivalent "Mbi sitemet e menaxhimit të cilëse" ose ISO 13485:2016 "Sitemi i menaxhimit të cilëse për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.1.2 Ofertuesi duhet të paraqesë Autodeklarate për Certifikimin ISO 9001:2015 ose/ ekuivalent "Mbi sitemet e menaxhimit të cilëse" ose ISO 13485:2016 "Sitemi i menaxhimit të cilëse për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent te prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: OE, në rastin e renditjes i pari në vlerësimin në SPE dhe përpara njoftimit të fituesit përfundimtar duhet të paraqesë certifikatën perkatese të prodhuesit sipas vetedeklarimit të bere. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4 pika a, neni 79 të LPP, neni 40, pika 6, neni 45 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës fondit limit/vlera e pritshme të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohej.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DST, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhezimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës**, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2020, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2021.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen vërtetime, të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të

*mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: [...] Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat etjështuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se **20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data eshpalljes së njoftimit të kontratës.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për Shqipërinë për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete original ose kopje e perkthyer dhe noterizuar.

Autorizimi duhet të jete i vlefshem në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.3 Ofertuesi duhet të paraqese Autodeklarate për kitet dhe materialet nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42 EEC, sipas aplikimit të vlefshmerise (të përditësuar) ose EU Regulation 2017/745 (amenduar me rregulloren EU 2023/607) ose 98/79/EC sipas aplikimit të vlefshmerise ose ose 98/34/EC sipas aplikimit të vlefshmerise, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese FDA ose CE/DC (deklarate konformiteti) kur është e aplikueshme sipas direktivave dhe klasifikimit të KE, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe, përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 4 pika a, neni 79 të LPP, neni 40, neni 45 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

Si dhe ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40 pika 5 a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

2.3.4 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të hollësishme të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë/kuqe), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqip ose anglisht e perkthyer dhe noterizuar). OE duhet të markojë në katalogun perkates produktet për të cilat oferton, sipas numrit rendor të percaktuar në formularin e Ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4 " *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohesh në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim." Si dhe ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 40 pika 5 a) *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe neni 41 pika 6 germa b.*

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

-Afati i kontrates nga lidhja e saj për një periudhë kohore 12 muaj

Në seksionin e specifikimeve teknike, *njësia e prokurimit* vendosi të njëjtat specifikime teknike dhe sasi e kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara në Relacionin e përlllogaritjes së fondit limit në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet njesia e prokurimit si më poshtë:

1. Prof,Asc Ilir Tasha Zv. Drejtor Teknik
2. Redi Hoxhallari Mjek Obstetër - Gjinekolog (specialist fushe)
3. Sidorela Dunolli Biologe-Embiologe (specialiste fushe)
4. Enkela Hoxha Ekonomiste
5. Kejsi Çunaj Farmacist